



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E POLICISË SË SHTETIT**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. _____ Prot., Datë _____.2018

Nr. ^{3348/1} _____ Prot., Datë 7.8.2018

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**“MBI
AKTIVITETET E KUNDËRLIGJSHME NË FUSHËN E TRASMETIMEVE
AUDIOVIZIVE”**

Ndërmjet:

- **Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit**, organ në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, që ka për mision ruajtjen e rendit e sigurisë si dhe garantimin e ligjit në përputhje me legjislacionin në fuqi,

dhe

- **Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)**, organ i pavarur, i cili rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Kryetari, Z. Gentian SALA;

Në vijim Palët,

Në zbatim të :

- Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 157, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”;
- Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Bien dakord të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi (më poshtë referuar si marrëveshja);

Neni 1 Objekti

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për objekt, rregullimin e marrëdhënieve dhe modaliteteve, ndërmjet DPPSH dhe AMA, në fushën e parandalimit, zbulimit dhe hetimit të personave që ushtrojnë aktivitet të kundërligjshëm, për bllokimin apo ndalimin e funksionimit të pajisjeve transmetuese audiovizive.

Neni 2 Qëllimi

Marrëveshja ka qëllim rritjen e shkallës së bashkëveprimit ndërinstitucional për një funksion efektiv të bashkëpunimit dhe përmirësimin e veprimitarisë së institucioneve, mbrojtjen e të drejtave dhe interesave pasurore dhe jopasurore të shtetit dhe shtetasve, veçanërisht në drejtim të parandalimit të pastrimit të parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, parandalimin e financimit të terrorizmit.

Neni 3 Bashkëpunimi

1. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për realizimin e detyrave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjit.
3. Palët e kësaj marrëveshjeje angazhohen të bashkëpunojnë në çdo rast në përputhje me objektin e kësaj marrëveshjeje, brenda fushës së kompetencave të parashikuara në legjislacionin që rregullon fushat respektive institucionale.
4. Bashkëpunimi ndërinstitucional do të realizohet në forma dhe drejtime të ndryshme, pavarësisht atyre të përcaktuara shprehimisht në nenet e kësaj marrëveshjeje.

Neni 4 Angazhimet

Në zbatim të kësaj marrëveshjeje palët marrin përsipër:

1. DPPSH

- 1.1. Të mbështesë strukturat e AMA-s gjatë veprimeve që do të kryehen prej tyre në rastet e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve të AMA-s nga subjektet audiovizive, për bllokimin apo ndalimin e funksionimit të pajisjeve transmetuese dhe sekuestrimin e tyre.
- 1.2. Të mbështesë strukturat e AMA-s në ekzekutimin e vendimeve për pezullimin e licencës/autorizimit, në rastet kur subjektet kundravajtës refuzojnë zbatimin e tyre.

1.3. Të mbështesë veprimet e personelit të AMA-s në rastet kur kundërshtohen apo kërcënohen me dhunë gjatë kryerjes së detyrave funksionale dhe ligjore. “Në të gjitha rastet kur gjatë realizimit të mbështetjes nga ana e personave kundravajtës të subjekteve audiovizive kryhen veprime të dhunshme për pengimin, kundërshtimin apo goditjen fizike të përfaqësuesve të AMA-s, të kryhen veprimet procedurale dhe referimi i tyre në organin e prokurorisë për ndjekje të mëtejshme.

1.4. Në të gjitha rastet kur gjatë realizimit të mbështetjes nga ana e personave kundravajtës të subjekteve audiovizive kryhen veprime të dhunshme për pengimin, kundërshtimin apo goditjen fizike të përfaqësuesve të AMA-s, të kryhen veprimet procedurale dhe referimi i tyre në organin e prokurorisë për ndjekje të mëtejshme.

1.5. Në përfundim të realizimit të mbështetjes, drejtuesi i shërbimeve policore të nënshkruajë procesverbalin e realizimit të mbështetjes të hartuar bashkërisht me përfaqësuesit e AMA-s, të marrë dhe administrojë një kopje të tij.

2. AMA

2.1. Të paraqesë kërkesën me shkrim në strukturat e Policisë së Shtetit/Drejtorive Vendore të Policisë përkatëse, për të gjitha rastet kur kërkohet mbështetja.

2.2. Të jetë e pranishme gjatë procesit të bllokimit apo ndalimit të funksionimit të pajisjeve transmetuese, sekuestrimit të tyre, në rast se kërkohet prania e përfaqësuesve të DPPSH.

2.3. Të njoftojë menjëherë DPPSH, në rast se konstaton kryerjen e aktiviteteve tregtare të paligjshme në fushën e medieve audiovizive, përfshirë prodhimin, importimin, shpërndarjen, shitjen për qëllime tregtare të pajisjeve të ndaluara.

2.4. Të shfrytëzojë maksimalisht burimet njerëzore dhe materiale në funksion të bashkëpunimit institucional sipas kësaj marrëveshje.

2.5. Të marrë përsipër magazinimin dhe ruajtjen e pajisjeve transmetuese të bllokuara apo sekuestruara gjatë kryerjes së bashkëpunimit.

Neni 5

Mënyrat e bashkëpunimit

1. Për zbatimin e kësaj marrëveshje palët do të komunikojnë në rrugë zyrtare, duke mos përjashtuar edhe format më të shpejta të komunikimit.

2. Në zbatim të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, palët e kësaj marrëveshje do të caktojnë nga një person kontakti.

3. Në njoftimin dhe parashtrimin e nevojës për bashkëpunim, nga secila prej palëve përcaktohen detaje të tilla si vendi, data dhe ora e kryerjes së veprimeve të bashkërenduara, apo të dhëna të tjera.

4. Palët do të njoftohen reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

5. Për zbatim të kësaj marrëveshje, personat e kontaktit do të jenë;

Për DPPSH: Drejtues Albert Dervishaj,
Drejtor i Drejtorisë së Rendit Publik
Departamenti i Sigurisë Publike
(ALBERT.DERVISHAJ@ASP.gov.al)

Për AMA : Z/ZNJ DilfirusVrioni
(dilfirus.vrioni@ama.gov.al)

Neni 6

Përdorimi i informacionit dhe konfidencialiteti

1. Secila nga palët e kësaj marrëveshjeje do ta përdorë informacionin e marrë vetëm për rastet e ushtrimit të funksioneve të saj ligjore për qëllimet e përcaktuara në kërkesë ose për qëllime brenda kuadrit të përgjithshëm të përdorimit të shprehura në kërkesë.
2. Veprimet nga palët nënshkruese sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në mënyrë të veçantë shkëmbimet e informacioneve, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrotjen e të dhënave personale.
3. Çdo palë e kësaj marrëveshjeje duhet të ruajë informacionin që merr nga pala tjetër në përputhje me normën e konfidencialitetit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për mbrotjen e të dhënave personale.
4. Palët nuk kanë të drejtë të vënë në dispozicion të ndonjë palë të tretë informacionin që kanë marrë sipas objektit të kësaj Marrëveshjeje, pa marrë më parë miratimin paraprak të palës që jep informacionin.
5. Palët do të trajtojnë informacionin e marrë në zbatim të kësaj marrëveshjeje dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Takime të përbashkëta

1. Çdo 6 (gjashtë) muaj titullarët e secilës prej palëve në këtë marrëveshje bashkëpunimi do të zhvillojnë takime për të diskutuar ecurinë e implementimit të saj, me qëllim që të ndërtohet një sferë sa më e sigurt dhe efikase, duke përcaktuar drejtimit për të garantuar zbatimin e legjislacionit në fuqi.
2. Me iniciativën e secilës palë, për probleme të caktuara, takimet mund të bëhen në çdo kohë edhe me nivelet hierarkike të ndryshme përveç titullarëve.

Neni 8

Përmirësimet dhe ndryshime

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe shtesa në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
2. Çdo shtesë dhe ndryshim do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e palëve të kësaj.

3. Marrëveshje, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

Neni 9 **Dispozita përfundimtare**

1. Për çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve të mësipërme, secili përfaqësues njofton titullarin e institucionit.
2. Çdo mosmarrëveshje midis palëve për shkak të moszbatimit të kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje do të zgjidhen me mirëkuptim në rrugë administrative.
3. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vlefshme deri në shfuqizimin e saj me vendim të palëve nënshkruese.
4. Kjo marrëveshje nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) për secilën palë.

Dispozitat e kësaj marrëveshje zbatohen nga palët nënshkruese në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I
TË POLICISË SË SHTETIT**

Drejtues Madhor Ardi VELIU



**KRYETARI I AUTORITETIT
MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Gentian SALA

